

  
**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E SHENDETESISË**  
**MINISTRI**

Tiranë, më 9.2 2012

Nr. 494 Prot.

**UDHËZIM**

Lënda: Mbi planifikimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë në institucionet shëndetësore.

Në funksion dhe në zbatim të ligjit Nr. 10107, datë 30.03.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", neni 33 "Edukimi i vazhdueshëm profesional", për çdo institucion që ofron kujdes shëndetësor ka detyrimin dhe përgjegjësinë të organizojë apo mundësojë zhvillimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për të gjithë personelin mjekësor brenda institucionit.

Në nenin e sipërpërmendur citohet se:

*"Profesionistët e kujdesit shëndetësor janë të detyruar ti nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm profesional të përditësuar, për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që të rrisin cilësinë e kujdesit shëndetësor"*

*"Punësimi, privilegjet ose kontratat në institucionet shëndetësore përfundojnë, nëse stafi profesionist nuk i nënshtrohet procesit të edukimit të vazhdueshëm, të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë"*

*"Institucionet e kujdesit shëndetësor u nënshtrohen sanksioneve në rast se ato punësojnë specialistë, të cilët nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në këtë nen"*

Në zbatim të këtij ligji, Ministria e Shëndetësisë ka miratuar Dokumentin Rregullator për Ricertifikimin e profesionistëve të shëndetësisë, ku përcaktohet se të gjithë profesionistët e shëndetësisë që ofrojnë kujdes shëndetësor (mjekë, stomatologë dhe farmacistë), duhet të mbledhin 150 kredite në 5 vjetët e para të programit të ricertifikimit (janar 2010-dhjetor 2014)

Për vitin 2012, numri minimal i detyrueshëm i krediteve për profesionistët e shëndetësisë është 15 kredite dhe numri i rekomanduar është 30 kredite.

Në këtë kuadër të gjithë drejtuesit e institucioneve shëndetësore si: qendra shëndetësore të kujdesit shëndetësor parësor, spitale rajonale dhe lokale, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", qendra të tjera spitalore universitare, institucione të shëndetit publik dhe drejtoritë rajonale të shëndetit publik, kanë detyrimin dhe përgjegjësinë për të planifikuar,

dhe organizuar aktivitete të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë brenda institucioneve të tyre.

Llojet e aktiviteteve që mund të organizohen brenda institucioneve janë :

- mbledhje klinike,
- studime rasti,
- aktivitete mësimore në grupe të vogla që përfshijnë leksione/ apo prezantim të studimeve shkencore bashkekohore/materiale shkencore në video etj.,
- trajnime në punë e sipër

Këto aktivitete të thjeshta brenda institucioneve dhe pa kosto të lartë duhet të planifikohen të paktën një herë në muaj, me një kohëzgjatje 1 deri në 2 orë në varesi të tematikës dhe llojit të aktivitetit.

Të gjitha aktivitetet e sipërpërmendura do të akreditohen nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim, në përputhje me dokumentin rregullator të akreditimit të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Drejtnesit e institucioneve shëndetësore brenda datës 31 mars 2012 duhet të planifikojnë aktivitetet që do organizohen nga vetë profesionistët e qendrës apo institucionit shëndetësor dhe të dorëzojnë formularët e aplikimit për akreditim për aktivitetet e planifikuara pranë Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim (QKEV). Formulari i aplikimit i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Aktivitetet e organizuara nga institucionet shëndetësore për vitin 2012 duhet të ofrojnë minimalisht 15 kredite për pjesëmarrësit në to. Ju kujtojmë që 15 kredite janë të barazvlefshme me 15 orë efektive (prezantim, diskutim, pyetje) të aktiviteteve të mësipërme.

Për të bërë të mundur realizimin e kësaj detyre, drejtnesit e këtyre institucioneve duhet të ngarkojnë një punonjës të institucionit për organizimin dhe mbarëvajtjen e këtij procesi.

Për të ndihmuar organizatorët e këtyre aktiviteteve, QKEV mund t'ju vëre në dispozicion pajisje të domosdoshme për organizimin e këtyre aktiviteteve si projektor apo laptop si dhe t'ju ofroje asistencën e nevojshme teknike.

Për më shumë informacion, drejtnesit apo të ngarkuarit e institucioneve shëndetësore me organizimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim mund t'i referohen dokumentit "Udhëzuesi i planifikimit institucional të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë" të cilin mund ta gjeni në faqen e QKEV-së në internet ([www.qkev.gov.al](http://www.qkev.gov.al)).

Të merren masa për zbatimin në kohë të këtij udhëzimi në përmbushje të kërkesave të këtij të sipërpërmendur.

